



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.23, datë 30.04.2007

**PËR
MIRATIMIN E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2006
DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 19, pika 1-8, dhe neni 32, gërma "dh", ndryshuar me ligjin Nr.9208, datë 18.03.2004, ligjit Nr.8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin Nr.8871, datë 29.03.2002, ligjit Nr.9645, datë 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimit Nr.335, datë 17.01.2007 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë realizimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006, sipas pasqyrave Nr.1, 1/1, 1/2, 1/3, 1/4, 1/5, 2, 2/1, 2/2 dhe Nr.3 pjesë përbërëse të këtij Vendimi.
2. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007, detajuar si më poshtë:

- Fondi i mbartur nga viti 2006	345.946.456 lekë
- Të ardhura tatimore	3.461.000.000 lekë
- Të ardhura jotatimore	<u>900.710.000 lekë</u>
Totali	4.707.656.456 lekë

3. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007, si më poshtë:

Fond për shpenzime korrente (të ardhurat e Bashkisë)	2.683.608.456 lekë
Fond për shpenzime i deleguar nga Pushteti Vendor	1.293.580.000 lekë
Fond për shpenzime kapitale (investime nga të ardhurat)	<u>2.288.387.000 lekë</u>
	6.265.575.456 lekë

4. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007 sipas pasqyrave Nr.1, 2, 3, 3/1, 3/2, 3/3, 4, 4/1 pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike të kryejë avancimin e fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2007.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Prokurimit Publik, Njësitë Bashkiake, Institucionet në varësi të Bashkisë.
7. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

SOKOL DERVISHAJ